

Translation into Albanian

Çfarë kryen Lewisham Homes?

Çfarë kryen Lewisham Homes?	Çfarë kryen Këshilli i Lewisham?
Jep dhe menaxhon garazhet	Monitoron Lewisham Homes
Kryen punimet kryesore	Zhvillimet e reja në fushën e banesave
Trajton çështjet e banimit	Përfitime për shtëpi
Mbledh pagesat për qiranë dhe shërbimin	Ndarjen e banesave
Pastron dhe mirëmban pronat	Rigjenerimin e pronave
Trajton Sjelljet Antishoqërore	Rrugët dhe ndriçimin
Trajton çështjet e qiramarrjes	Pastrimin e rrugëve
Përfshirjen e banorëve	Automjetet e braktisura
Trajton ankesat mbi shërbimin e Lewisham Homes	Mbështetje për strehimin
Aplikon të Drejtën për të Blerë	Personat pa shtëpi dhe transferimet
Merret me banesat e zbrazura dhe zaptimin e paligjshëm të tyre	Cakton qiranë

Në lidhje me banimin tuaj me qira

Marrëveshja juaj e qiramarrjes është një kontratë ligjore mes jush dhe Këshillit të Lewisham. Ajo është e hartuar në mënyrë të tillë që të sigurojë që ju dhe banorët e tjerë të jeni fqinj të mirë dhe të tregoni kujdesin e duhur për shtëpitë që keni marrë me qira.

Marrëveshja përcakton disa rregulla të cilat ju, ata që jetojnë me ju ose që vizitojnë shtëpinë tuaj, duhet t'i zbatoni me ligj. Marrëveshja e qiradhënies ju jep të drejta si dhe përgjegjësi. Ajo gjithashtu përmban listën e shërbimeve që ju takojnë sipas qirasë që paguani.

Lewisham Homes është agjencia që menaxhon mbi gjysmën e shtëpive të Këshillit të Lewisham. Këshilli kërkon nga Lewisham Homes që të mbledhë qiranë dhe ta mbajë shtëpinë tuaj të sigurt si dhe të kryejë meremetimet e duhura. Lewisham Homes gjithashtu sigurohet që ju dhe banorë të tjerë të Lewisham të jepni kontributin tuaj që lagja juaj të bëhet një vend i këndshëm banimi.

Përgjegjësitë tuaja

Përgjegjësitë tuaja si banor

- Kjo shtëpi duhet të jetë vendi juaj kryesor i banimit. Nëse për ndonjë arsye shtëpia juaj do të mbetet bosh për më shumë se gjashtë javë, atëherë për këtë duhet të lajmëroni Lewisham Homes
- Banorët e tjerë duhet t'i trajtoni ashtu si do të donit t'ju trajtonin juve
- Është në përgjegjësinë tuaj që vizitorët që hyjnë në banesën tuaj të mos shkelin asnjë pjesë të marrëveshjes së qiramarrjes
- Pjesën brenda dhe jashtë shtëpisë suaj si dhe kopshtet apo zonat e shtruara që përdorni duhet t'i mbani të pastra dhe të rregullta
- Gjithashtu nuk duhet të lejoni që shtëpia të marrë lagështi brenda

Përgjegjësia juaj për mirëmbajtjen e shtëpisë suaj

Është përgjegjësia juaj zbulimi i pjesëve të brendshme të shtëpisë suaj dhe riparimi apo zëvendësimi i artikujve me të cilat keni pajisur banesën.

Nëse ju, dikush që jeton me ju, një vizitor apo dikush që keni punësuar, dëmton cilëndo pjesë të shtëpisë, atëherë ju duhet të organizoni dhe të paguani për riparimet e nevojshme. Këtu përfshihet edhe dëmi i shkaktuar nga policia nëse atyre u duhet të hyjnë me forcë në shtëpinë tuaj.

Përpara se të ndryshoni diçka në shtëpi, në fillim ejani të kontrolloni nëse ju lejohet ta bëni këtë ndryshim. Nëse vazhdoni pa marrë miratim me shkrim nga këshilli, mund të rezultojë që të paguani që punimet që keni bërë të kthehen në gjendjen fillestare.

Përgjegjësia juaj për të paguar qira

Si qiramarrës ju keni përgjegjësinë të paguani qiranë në kohë. Kryerja e rregullisht e pagesave të qirasë është jashtëzakonisht e rëndësishme. Shërbimet tona ne mund t'i përmirësojmë vetëm nëse kemi paratë që nevojiten për t'i paguar ato. Nëse nuk jeni në gjendje të paguani një këst qiraje, atëherë ju lutemi na kontaktoni. Ne jemi në gjendje t'ju ndihmojmë me këshilla financiare si dhe të aplikoni për të marrë përfitime.